



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 943/01-5029 dt. 29.01 2024



Bazuar në nenin 11,12,dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe kërkesës për ndarje nr.09-942/03-2024 të dt.11.01.2024. Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.01.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

Për ndarjen dhe bashkimin e parcelave kadastrale

Neni 1

Me këtë vendim, miratohet ndarja dhe bashkimi të parcelave kadastrale në Tërstenik dhe Nekoc, me qëllim të realizimit të projektit për ndërtimin e objekteve të qerdheve.

Neni 2

Parcelat që kërkohen të ndahen dhe bashkohen, janë si më poshtë:

1. Parcela kadastrale Nr.175-0 zona kadastrale Tërstenik, propozohet që të bëhet ndarja e parcelës kadastrale me sipërfaqe $S=0.35.00$ ha.
2. Parcelat kadastrale 365-0, 364-1 dhe 364-2 zona kadastrale Nekoc, propozohet ndarja dhe bashkimi i parcelave kadastrale, dhe të krijohet një parcelë e re me sipërfaqe $S=0.25.00$ ha.

Neni 3

Qëllimi i ndarjes dhe bashkimit të parcelave kadastrale 175-0 në zk. Tërstenik dhe parcelat 365-0, 705364-1-0 dhe 364-2 zona kadastrale Nekoc, bëhet për t'i hapur rrugë ndërtimit të qerdheve në fshatin Tërstenik dhe Nekoc.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.


Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Milaim Hajdari




ARSYETIM

Me qellim të realizimit të investimit nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për ndërtimin e qerdhës në fshtin Tërstenik dhe Nekoc, kërkohet që të bëhet ndarja dhe bashkimi i parcelave kadastrale si më poshtë:

Për të realizuar ndërtimin e qerdhës në fshatinë Tërstenik, nevojitet një sipërfaqje prej 3500 m², prandaj edhe do të bëhet ndarja e parcelës 175-0, ku nga sipërfaqje e përgjithshme e kësaj parcela do të ndahet sipërfaqja prej 3500 m², ndërsa për të realizuar ndërtimin e qerdhës në fshatinë Nekoc nevojitet një sipërfaqje prej 2500 m², prandaj edhe do të bëhet ndarja dhe bashkimi i parcelave 365-0, 364-1 dhe 364-2.

Baskangjtur i gjeni:

- Fletat poseduese
- Kopjet e planit dhe
- Skicat e propozuar për ndarje/bashkim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glogocit Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glogocit	
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI	
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor	Nr. XL-26/24 Datë: 13.02.2024
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendimi 02 Nr. 943/01-5029 për ndarjen dhe bashkimin e parcelave në Terstenik dhe Nekoc, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glogocit, datë 29.01.2024	

I nderuar kryetar Lladrovci,
I nderuar kryesues Hajdari,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me datë 01.02.2024 ka pranuar nga MAPL Vendimin 02 Nr. 943/01-5029 për ndarjen dhe bashkimin e parcelave në Terstenik dhe Nekoc, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glogocit, datë 29.01.2024.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave:

KONFIRMON

Vendimin 02 Nr. 943/01-5029 për ndarjen dhe bashkimin e parcelave në Terstenik dhe Nekoc, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glllogocit, datë 29.01.2024.

ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Vendimi i sipërshtënuar është i bazuar në Udhëzimin Administrativ Mmph - Nr. 12/19 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës dhe në Kornizën e Punës për Matje. Andaj, mund të vazhdohet me procedurën për ndarjen e parcelës, pasi e njëjta është në pronësi të komunës.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Komunës së Glllogocit dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

